



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 46/19
Prishtinë, më 06.03.2019, në orën 16:45
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Mergim Lushtaku, Dardan Molliqaj, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Lumir Abdixhiku, Jelena Bontic, Naser Osmani, Ali Lajçi dhe Arbërie Nagavci.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadegjonaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Punën të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike;**

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit: Theksoi se ka biseduar me Kryetarin e Komisionit dhe ai ka thënë se është jashtë vendit dhe ai ka propozuar që mbledhja të mbahet nesër prej orës 8:45. Duke pasur parasysh se seanca e jashtëzakonshme është caktuar për nesër prej orës 9:00, me kërkesën e shumicës së nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit (gjashë nënshkrime), në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, kam thirrur mbledhjen e Komisionit për sot, pra me datë 06.03.2019, prej orës 16:45, në sallën C-203, ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, me pikën e rendit të ditës, si vijon:

“Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Punën të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike”

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Punën të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit: Theksoi se Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë dhe të gjitha ndikimet buxhetore që do të mund të dalin, duhet të mbulohen nga ndarjet buxhetore për vitin 2019. Po ashtu as amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit,

Safete Hadergjonaj